

ETIKA E BIZNESIT

PARIMET ETIKE NE BIZNES

MODULI 3

PARIMET ETIKE NE BIZNES

1. Dobishmeria – kostot sociale dhe perfitimet
 - Dobishmeria tradicionale dhe ceshtje te vleresimit te saj

2. Te drejttat dhe koncepti mbi to
 - Te drejttat pozitive dhe negative
 - Te drejttat dhe detyrimet kontraktuale

3. Drejttesia dhe sinqeriteti
 - Drejttesia ne shpendarje
 - Drejttesia si barazi – egalitarizmi
 - Drejttesia qe bazohet ne kontribute – Drejttesia kapitaliste
 - Drejttesia qe bazohet ne nevojat dhe aftesite – Drejttesia socialiste
 - Drejttesia si liri – Liberalizmi

- Vlerësimi për një çështje të caktuar, për shembull, mjaftueshmëria morale e ligjeve, e institucioneve, apo e aktiviteteve të biznesit, lidhet me tre llojet bazë të SM-ve *dobishmëria, të drejtat dhe drejtësia.*
- Sipas *dobishmërisë*, një veprim është i drejtë deri në shkallën që ai ndikon në zvogëlimin e kostove sociale dhe në shtimin apo rritjen e përfitimeve sociale.
- *të drejtat* e individëve bazohen në parimet morale, të cilat tregojnë hapësirat në të cilat duhet respektuar liria e individëve, ndërsa
- *drejtësia* bazohet në parimet morale që identifikojnë mënyrat e shpërndarjes së drejtë të përfitimeve apo edhe të kufizimeve midis antarëve të një shoqërie.

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- “Dobishmëria” - një term i përgjithshëm, që përdoret në rastin kur veprimet, politikat dhe institucionet duhet të vlerësohen në bazë të analizës së kostove dhe të përfitimeve që ato i shkaktojnë shoqërisë.
- Sipas konceptit të dobishmërisë, një politikë, institucion apo veprim është i drejtë kur ai siguron që përfitimet neto të jenë më të mëdha, ndërsa kostot neto më të ulëta.
 - Përfitimet e një veprimi përfshijnë, vec shumave monetare që mund të maten, edhe cdo të mirë tjetër të dëshirueshme (kënaqësi, shëndet, jetë, sadisfaksion, njohuri, lumturi, etj.) që rrjedh nga kryerja e veprimit; ndërsa
 - Kostot përfshijnë cdo të keqe të padëshirueshme (dhimbje, sëmundje, vdekje, injorancë, palumturi, etj.).
- Dobia - perf.neto (diferenca midis përfitimeve dhe kostove)
- **Përgjegjësia sociale** që duhet të mbajë një biznes **është ajo që garanton fitimet neto më të mëdha për shoqërinë ose që imponon kostot neto më të ulëta.**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- Efektet e veprimit
 - Mund të maten dhe përfitimi i ardhur prej tij mund të rritet dhe, nga ana tjetër,
 - Mund të matet dhe të zvogëlohet vlera e efektit negativ që mund të shkaktojë ky veprim.
- parimi i dobishmërisë- të gjitha përfitimet dhe kostot e një veprimi mund të maten me anë të një vlerësimi të zakonshëm numerik ($\sum P - \sum K$).
- Sipas themeluesit të dobishmërisë tradicionale Jeremy Bentham-“
- mënyra më drejtë e kryerjes së një veprimi do të ishte ajo që do të prodhonte shumën më të madhe të dobisë”

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- Sipas pikëpamjes tradicionale, - një *veprim është i drejtë nga pikëpamja etike*
- **në qoftë se dhe vetëm në qoftë se**
- *shuma totale e dobisë të prodhuar prej tij është më e madhe se sa shuma totale e dobisë të prodhuar nga ndonjë veprim tjetër që do të mund të ishte kryer në vend të tij ...*

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- Disa nga moskuptimet apo keqkuptimet
- **Dobia per te gjithë**
 - Një veprim konsiderohet i drejtë, në qoftë se ai siguron dobi për të gjithë individët që ndikohen prej tij (përfshirë edhe individin që kryen veprimin)
 - Keqkuptimi - veprimi i drejtë **është ai që jep më shumë dobi për një individ të caktuar apo për individin që e kryen veprimin.**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **Jo vetem perfitimet.>kostot**
 - dobishmëria pretendon se në analizën finale **vetëm një veprim rezulton të jetë i drejtë: ai, përfitimet neto të të cilit janë më të mëdha, të krahasuara me përfitimet neto të të gjitha alternativave të tjera të mundëshme.**
 - Keqkuptimi - veprimi është i **drejtë në cdo rast që përfitimet i tejkalojnë kostot.**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- parimi dobishmërisë kërkon që të merren në konsideratë jo vetëm pasojat direkte apo të menjëherëshme, por gjithashtu, edhe kostot dhe përfitimet që parashikohen për të ardhmen, si edhe efekte të tjera indirekte sinjifikative.
- **Keqkuptimi - Shqyrtimi vetëm i pasojave direkte dhe të menjëherëshme të veprimeve.**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **Për të shmangur keqkuptimet ne një situatë të caktuar, duhet të ndërmerren tri hapat e mëposhtëme:**
- **(1) të vlerësohen dhe të përcaktohen veprimet apo politikat epërshtatëshme alternative.**
- **(2) për cdo veprim apo politikë alternative, vlerësohen përfitimet dhe kostot direkte e indirekte, ndaj cdo individi të ndikuar nga ky veprim gjatë një periudhe kohe të ardhëshme të parashikueshme.**
- **(3) alternativa që siguron shumën totale më të madhe të dobisë, duhet të zgjidhet si veprimi alternativ më i përshtatshëm nga pikëpamja etike.**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

Disa nga aplikimet dhe avantazhet

- **Vleresimi i politikave qeveritare**

- politika qeveritare të mira janë ato të cilat japin dobinë më të madhe të matëshme për publikun - të cilat prodhojnë - të mirën më të madhe për numrin më të madh
- pranoen **ato projekte**, objektivat e studiuara të të cilëve, tregojnë se ato do të japin **përfitimet më të mëdha për anëtarët shoqërisë dhe do të kryhen me koston më të ulët.**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- Disa nga aplikimet dhe avantazhet
- Dobishmëria duket se përshtatet **saktësisht me kriteret intuitive**, me të cilat njerëzit diskutojnë për sjelljet morale.
 - Për shembull, për të shpjeguar arsyen pse individët **kanë detyrime morale** për të kryer një veprim të caktuar, ata menjëherë do të venë në dukje **përfitimet dhe dëmet** që shkakton veprimi.
 - moraliteti kërkon të merren parasysh, në mënyrë të paanëshme, interesat e të gjithë atyre që preken apo ndikohen nga veprimi.

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- Disa nga aplikimet dhe avantazhet
- Dobishmëria - ndihmon të **shpjegohen tipet apo llojet e veprimtarive që janë**
 - **moralisht të gabuara** (si për shembull gënjeshtria, mashtrimi, vrasja etj.) dhe tipet apo llojet e veprimtarive që **janë**
 - **moralisht të drejta** (si për shembull tregimi i të vërtetës, besimi, mbajtja e premtimit, etj.).

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- Pikëpamjet e dobishmërisë gjithnjë kanë patur ndikime të mëdha në ekonomi.**
- Ekonomistët argumentojne se sjellja ekonomike, mund të shpjegohet me supozimin që qeniet njerëzore gjithmonë synojnë të maksimizojnë dobinë, e cila mund të matet nëpërmjet cmimeve që ata janë të gatshëm të paguajnë për mallrat e shërbimet.**
- një sistem tregu i konkurrencës të përkryer mund të cojë në një përdorim të burimeve dhe cmimeve të ndryshme, të cilat do t'u japin mundësi konsumatorëve që të maksimizojë dobinë e tyre nëpërmjet blerjeve.**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **Dobishmëria është “baza e teknikave të analizës ekonomike kosto-perfitim**
- **Vlerësimi i investimit në një projekt të caktuar ku llogariten:**
 - **përfitimet e tanishme dhe të ardhëshme si dhe**
 - **kostot e tanishme e të ardhëshme,**
- **përfitimet duhet t’i tejkalojnë kostot e llogaritura.**
- **Këtu koncepti i dobishmërisë reduktohet në matjet ekonomike të kostove dhe të përfitimeve**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **dobishmëria përshtatet me eficencën**
 - të operosh në mënyrë të tillë që me burimet disponibël të prodhosh sa më shumë të jetë e mundur
- një veprim eficient është ai që prodhon një output të dëshiruar me sasinë minimale të inputit.

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **Problemet qe shoqerojne parimin e dobihmerise (a) vështirësia në matjen e dobisë.**
- Ka vështirësi në matjen e dobisë së veprimeve të ndryshme dhe në krahasimin e saj me dobinë e kërkuar
- Dobia e punësimit në një vend pune të njërit prej dy personave me kualifikim të ngjashëm
- përsa kohë nuk dimë se cili prej punësimeve do të prodhonte dobinë më të madhe, për atë kohë ne nuk jemi në gjendje të zbatojmë parimin e dobishmërisë.

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **(b) shumë përfitime dhe kosto të një veprimi dukent të pamundura për t`u vlerësuar.**
 - matja e vlerës së shëndetit apo të jetës.
- **(c) disa përfitime dhe kosto nuk mund të parashikohen në mënyrë të besueshme, dhe nuk mund të maten në mënyrë të mjaftueshme.**
 - Përfitimet nga rezultatet paraprake të kërkimeve shkencore.

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- (d) paqartësia që haset në specifikimin e asaj që duhet llogaritur si përfitim dhe asaj që duhet llogaritur si kosto
 - problematike për çështjet sociale, për të cilat grupe të ndryshme kulturore japin vlerësime të ndryshme.
- E vetmja mënyrë e zgjidhjes së problemeve (a, b, c dhe d) është të pranohen në mënyrë arbitrare vlerësimet e një grupi social apo të një grupi tjetër - rrugë e cila e vendos analizën kosto-përfitim të studiuesve të dobishmërisë në baza subjektive dhe brenda shijeve të një grupi të caktuar.

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- Mbrojtësit e parimit të dobishmërisë kundërshtojnë duke argumentuar se ndonëse dobishmëria, në mënyrë ideale, **kërkon matje të sakta sasiore të të gjitha kostove dhe përfitimeve, kjo kërkesë mund të mos zbatohet kur matjet janë të pamundura.**
- Parimi vetëm insiston që pasojat e një veprimi të deklarohen shprehimisht saktë e qartë me qëllim që pasojat të krahasohen sistematikisht, dhe në këtë mënyrë t'u jepet rëndësia e duhur kundrejt njera-tjetrës.
- **Shprehja e informacionit në terma sasiore shërben vetem për të lehtësuar krahasimin.**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **Per t`u dhënë vlerë relative kategorive të ndryshme të të mirave (pasojave) dhe për të bërë të mundur përdorimin e këtij parimi kur shprehja sasiore është e pamundur përdoren kritere të arsyeshme:**
- **(i) dallimi (epërsia) që ekziston midis të mirave të brendëshme dhe të mirave instrumentale.**
- **Të mirat instrumentale janë të mira që konsiderohen të vlefshme vetëm sepse cojnë (udhëzojnë) në të mira të tjera**
- **Të mirat e brendëshme janë të mira të dëshirueshme, pavarësisht nga përfitimet e tjera që ato mund të gjenerojnë p.sh. shëndeti është një e mirë e brendëshme.**
- **të mirat e brendëshme (të qënësishme) kanë prioritet ndaj atyre instrumentale.**
- **P.sh. në shumë rrethana paraja (një e mirë instrumentale) nuk ka prioritet ndaj jetës apo shëndetit (një e mirë e brendëshme).**

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- (ii) dallimi midis nevojës dhe dëshirës.
- Të thuash se një individ ka nevojë për dicka do të thotë se ai pa të s'mund të jetojë ose do të dëmtohet në një farë mënyre.
- Nevojat bazë të njerëzve, jane **për gjëra, pa të cilat ata do të vuajnë disa dëmtime fundamentale** sic janë sëmundjet apo vdekja.
- Në përgjithësi, kënaqja e një nevoje bazë të njeriut është më e vlefshme sesa kënaqja e një dëshire të tij.
- Këto mënyra gjykimi me anën e të cilave peshohen të mirat kanë për qëllim që të ndihmojnë pikërisht në situatat kur është e pamundur të merren tregues të matjes sasiore.

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **Metoda më fleksibile** për te vleresuar përfitimet dhe kostot që shoqërojnë një vendim, është **përdorimi i ekuivalentëve monetare**.
- Kjo nënkupton që **vlera që një e mirë ka** për një individ, mund të **matet me anë të cmimit** që ky individ është i gatshëm të paguajë për të.
- ka avantazhin se jep mundësi të **merren parasysh faktorët kohë e pasiguri**.
- -skontimet; llogaritjet me ndihmëne probabilitetit

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- **Metoda kundërshtohet për faktin që:**
- disa të mira, në vecanti shëndeti dhe jeta, nuk mund të cmohen (pasi është e pamundur që atyre t'ju vendoset cmim).
- Ndërsa mbrojtësit kundërargumentojnë: përderisa njerëzit caktojnë një limit në sasinë e parave që ata janë të gatshëm të paguajnë **për të reduktuar rrezikun që çënon jetën e tyre**, ata përcaktojnë në këtë mënyrë, njëfarë **cmimi për jetën e tyre**.

1. Dobishmëria-Analiza krahasuese midis kostove dhe përfitimeve sociale

- Megjithatë në përdorimin e metodave të dobishmërisë ka dy kufizime kryesore në këndvështrimin e arsytimit moral.
 - *Së pari*, ato janë të vështira për tu përdorur për vlerësime që janë të vështira e ndoshta të pamundura të maten nga ana sasiore.
 - *Së dyti*, dobishmëria në vetëvete duket se nuk është marrë sa duhet me situatat që lidhen me të drejtat dhe drejtësinë.

2. Të drejtat

- Koncepti i “të drejtës”, shfaqet në shumë argumente morale që lidhen me veprimtarinë në biznes.
- Punonjësit kanë të drejtë që për punë të barabartë të marrin paga të barabarta;
- menaxherët pohojnë se sindikatat dhunojnë të drejtën e tyre për të menaxhuar; etj.
- Në vitin 1948, Kombet e Bashkuara adoptuan një “Deklaratë Universale për të drejtat e njeriut”, sipas të cilës deklarohet se të gjitha qëniet njerëzore kanë midis të tjerash këto të drejta bazë:

2. Të drejtat

- e drejta për të patur pronë private si individ ose në formën e shoqërisë
- e drejta për punë, për të zgjedhur punësimin në mënyrë të lirë, për kushte pune të drejtat e të favorshme dhe e drejta për t`u mbrojtur nga papunësia
- e drejta e shpërblimit të drejtë e të favorshëm që garanton një jetesë të denjë e me dinjitet të individit e familjes së tij
- e drejta për të formuar e u organizuar në sindikata
- e drejta e pushimit dhe e kohës së lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orëve të punës dhe të periudhës së pagueshme të lejes, etj...

2. Të drejtat

- Koncepti i të drejtës
- Në përgjithësi, *e drejta* është dhënia e të drejtës për individin në mënyrë që ai të kryejë një veprim".
- Thuhet se individi ka një të drejtë kur atij i është dhënë më parë e drejta për të vepruar në një mënyrë të caktuar.
- Dhënia e të drejtës mund të burojë nga një sistem legjislativ që lejon individin të veprojë në një mënyrë të caktuar -“e drejtë ligjore”.
- kushtetuta e RSH garanton të drejten e fjalës, të drejten e tubimit, të drejten e pronës private

2. Të drejtat

- Dhënia e të drejtave buron, edhe nga sistemi i standarteve morale, pavarësisht nga ekzistenca e një sistemi ligjor të vecantë.
- Të drejtat morale, ndryshe nga të drejtat ligjore, mendohet se janë universale, pasi ato nuk kufizohen nga ndonjë juridiksion i caktuar.
- e drejta e qenieve njerëzore për të mos u torturuar

2. Të drejtat

- Të drejtat janë instrumente të fuqishme, që kanë për qëllimi kryesor:
 - (1) t'u japin mundësi individëve që të zgjedhin lirshëm ushtrimin (ndjekjen) e interesave apo të veprimtarive që ata duan të kryejnë dhe
 - (2) të mbrojnë këto zgjedhje.

2. Të drejtat

- *Së pari*, termin “e drejtë” e përdorim për të treguar **thjesht mungesën e ndalimeve** kundrejt ushtrimit të disa interesave apo aktiviteteve.
- *Së dyti*, termin “e drejtë” e përdorim për të treguar që një individ **autorizohet apo i jepet fuqi** të bëjë dicka, qoftë për të siguruar interesat e veta apo ato të të tjerëve.
- *Së treti*: shpeshherë termi “e drejtë” përdoret për të treguar **egzistencën e ndalesave ose të kërkesave (detyrimeve) mbi të tjerët**, të cilat e mundësojnë individin të ndjekë interesat e veta apo të kryejë veprimtari të vecanta.

2. Të drejtat

- Të drejtat morale më të rëndësishme janë ato të cilat imponojnë ndalesa ose kërkesa ndaj të tjerëve (të tretëve).
- (1) ju përkasin veprimtarive apo interesave për të cilat individët
 - janë të autorizuar t`i ushtrojnë, ose për të cilat ata
 - duhet të lihen të lirë për t`i ushtruar, apo
 - duhet të ndihmohen për t`i ushruar; dhe
- (2) përmbajnë edhe kushtet e mbrojtjes së individëve gjatë ushtrimit të tyre.

2. Të drejtat

- Për të përmbushur funksionet e dhënies së mundësisë për t'ushtuar dhe të mbrojtjes, të drejtat morale janë paisur me tri veti të rëndësishme:
 - a) janë të lidhura ngushtë me detyrimet.
 - përgjithësisht e drejta morale e një personi mund të përkufizohet – të paktën pjesërisht – me kushtet e detyrimeve morale që kanë të tjerët ndaj tij.
 - ... një individ i jepen të drejta vetëm në se ai pranon disa detyrime ndaj komunitetit që i jep këto të drejta.
 - ... të gjitha të drejtat e mija mund të përcaktohen tërësisht në kushtet e detyrave të tjerëve...

2. Të drejtat

- **detyrimet, përfaqësojnë anën tjetër të të drejtave morale.**
- **të drejtat morale imponojnë detyrime korrelative për të tjerët, qofshin këto detyrime të mosndërrhyrjes apo edhe detyrime që përmbajnë një performancë pozitive.**
 - Në disa raste **detyrimet korrelative që imponohen nga një e drejtë mund të mos lidhen në mënyrë specifike me një individ të vecantë, por me të gjithë anëtarët e një grupi të caktuar.**
 - E drejta për punë nuk do të thotë se një punëdhënës i caktuar ka detyrimin që të punësojë një individ të caktuar.

2. Të drejtat

- *b) i pajisin individët me autonominë dhe barazinë për ndjekjen (ushtrimin) e lirë të interesave të tyre. nje e drejte*
 - (1) identifikon veprimtaritë apo interesat, për të cilat njerëzit duhet të lihen të lirë për t'i ushtruar apo mos ushtruar, pasi ata i zgjedhin ato dhe
 - (2) ushtrimi i tyre nuk duhet të varet nga interesat e të tjerëve, përvecse në raste të vecanta, dhe për arsye vecanërisht të rëndësishme.

2. Të drejtat

- c) të drejtat morale japin një bazë për të justifikuar veprimet e dikujt dhe për të kërkuar mbrojtjen ose ndihmën e të tjerëve.
 - Liria për të vepruar
 - E drejta e të tjerëve për të mosndërhyrë
 - Detyrimi i justifikuar i të tjerëve për të ndërhyrë, për të shmangur pengesat.

2. Të drejtat

- Të drejtat morale japin bazat për të bërë gjykimet morale, të cilat ndryshojnë thellësisht nga standardet e dobishmërisë.
- *Në radhë të parë*, të drejtat morale shprehin kërkesat e moralitetit nga këndvështrimi i individit, kurse dobishmëria shpreh kërkesa të moralitetit nga këndvështrimi i shoqërisë në tërësi.
- *Në radhë të dytë*, në rast se një individ i caktuar ka të drejtë të bëjë dicka, atëherë është gabim që dikush tjetër të ndërhyjë, madje edhe në se nga një ndërhyrje e tillë mund të ndodhte që një numër i madh individësh mund të merrte më shumë dobi.
- *Në radhë të tretë* edhe pse të drejtat në përgjithësi qëndrojnë përpara standardeve të dobishmërisë, kjo s'do të thotë që ato janë në të gjitha rastet mbi konsiderimet e dobishmërisë.

2. Të drejtat

- Të drejtat klasifikohen në
 - të drejta negative,
 - të drejta pozitive dhe
 - të drejta speciale kontraktuale
- (i) Të drejtat negative përbëjnë atë mori të të drejtave të cilat dallohen nga fakti që antarët e tjerë të shoqërisë apo organizatës kanë detyrime që të mos ndërhyjnë në veprimtarinë e individit që gëzon një të drejtë ;
 - në rastin e të drejtës së fshehtësisë së jehës private (privacisë), çdo individ tjetër, duke përfshirë edhe punëdhënësin, ka detyrimin që të mos ndërhyjë në çështjet private të dikujt.
- Të drejtat negative janë përdorur më shumë në shekujt e XVII –XIX-të nga ata që hartonin manifestet që kishin poër qëllim të mbronin individët ndaj çënimeve që mund t`u vinin nga qeveritë monarkike.

2. Të drejtat

- (ii) **Të drejtat pozitive** më shumë **detyrojnë** se sa imponojnë detyrime negative.
- E drejta për të patur një standard të mjaftueshëm jetese, nuk do të thotë që të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë.
 - ***E drejta për punë, e drejta për arsimim, e drejta për kujdesin e duhur shëndetësor, e drejta për sigurime shoqërore janë të gjitha të drejta që shkojnë përtej mosndërhyrjes***, pasi të gjitha **këto të drejta**
 - **përmbajnë një detyrim pozitiv** për t'ju dhënë individëve dicka, kur ata nuk janë në gjendje që ta sigurojnë këtë vetë.
- Të drejtat pozitive u theksuan më shumë në gjysmën e dytë të shekullit të XX, kur shoqëria filloi të merrte më shumë përgjegjësi për të garantuar më shumë individët. Këto të drejta janë materializuar në dokumente të caktuara të organizmave ndërkombëtare apo në detyrime për institucionet qeveritare të vendeve të ndryshme.

2. Të drejtat

- Të drejtat dhe detyrimet kontraktuale (shpesh te quajtura “të drejta speciale” dhe “detyrime speciale”) përbëjnë të drejta të kufizuara dhe detyrime korrelative, të cilat lindin sa herë që një individ hyn në marrëveshje me një individ tjetër.
- Pa institucionin e kontratës me të drejtat dhe detyrimet që lindin prej tij, nuk mund të funksionojnë shoqëritë moderne të biznesit.

2. Të drejtat

- Cilat janë disa rregullat etike që drejtojnë kontratat?
- Në radhë të parë të dyja palët që kanë të bëjnë me kontratën duhet që të njohin në mënyrë të plotë natyrën e marrëveshjes në të cilën ato hyjnë.
- Asnjëra nga palët nuk duhet të keqinterpretojë në mënyrë të qëllimshme faktet e gjendjes kontraktuale ndaj palës tjetër.
- Asnjëra nga palët e kontratës nuk duhet të detyrohet që të hyjë me zor apo me detyrim në marrëveshje.
- Kontrata nuk duhet të shtrëngojë palët që të kryejnë një veprim jo-moral
- Kontratat që shkelin njëri nga këto katër kushte konsiderohen të pavlefshme

3. Drejtësia

- Drejtësia ka të bëjë me trajtimet krahasuese që ju bëhen anëtarëve të një grupi në raste të tilla si:
- në shpërndarjen e të ardhurave dhe të përfitimeve;
- në administrimin e rregullave dhe të ligjeve;
- kur anëtarët e grupit kooperojnë apo konkurrojnë me njeri-tjetrin;
- kur anëtarët e grupit ndëshkohen për gabimet që kanë bërë apo kur kompensohen për gabimet që të tjerët kryejnë ndaj tyre.

3. Drejtësia

- **Standardet e drejtësisë, përgjithësisht, janë më të rëndësishme se konsideratat e dobishmërisë.**
- **Standardet e drejtësisë, përgjithësisht nuk i shkelin të drejtat morale të individëve**
 - **drejtësia bazohet në të drejtat morale të individit**
 - **E drejta morale e disa individëve nuk mund të sakrifkohet vetëm e vetëm që të sigurohet një shpërndarje më e mirë e të ardhurave dhe e përfitimeve për të tjerët.**

3. Drejtësia

- Cështjet që kanë të bëjnë me drejtesinë, ndahen në tre kategori:
- - 1- **Drejtësia shpërndarëse** që ka të bëjë me ndarjen e drejtë e të sigurtë të të ardhurave dhe përfitimeve të shoqërisë midis anëtarëve të saj.
 - 2- **Drejtësia ndëshkuese** që i referohet imponimit të ndëshkimit dhe dënimit mbi ata që me ndërgjegje veprojnë në mënyrë të gabuar; dhe
 - 3- **Drejtësia kompensuese** - ka të bëjë me mënyrat e kompensimit të njerëzve për atë cka ata humbasin kur të tjerët veprojnë gabim ndaj tyre.

3. Drejtësia

- **1-Drejtësia shpërndarëse**
- Parimi themelor - **të barabartët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të pabarabartët në mënyrë të pabarabartë.**
- **Drejtësia si barazi:** Egalitarizmi. Sipas egalitaristëve, të gjitha përfitimet dhe detyrimet duhet të shpërndahen sipas parimit “**Cdo individ duhet ti jepet e njëjta pjesë të ardhurash apo cdo individ duhet të paguajë të njëjtën detyrim si edhe të tjerët**”.
- Egalitaristët e bazojnë pikëpamjen e tyre në pretendimin se të gjitha qeniet njerëzore janë të barabarta në disa drejtime kryesore dhe, mbështetur në këtë barazi, cdo individ duhet të ketë një pretendim të njëjtë me të tjerët ndaj të mirave të shoqërisë

3. Drejtësia

- **Drejtësia e bazuar në kontribut: drejtësia kapitaliste.**
- përfitimet dhe të mirat e shoqërisë duhet të shpërndahen në përputhje me kontributin e secilit në shoqëri,
- problemi kryesor i kësaj pikëpamje qëndron në mënyrën e matjes së kontributit të secilit.
- **kontributi mund të matet me anë të përpjekjeve në punë.** Sa më të mëdha të jenë këto përpjekje, aq më shumë do të fitojë individi.
- kontributi të matet me anë të **produktivitetit**. Sa më e madhe sasia e prodhuar dhe sa më e mirë të jetë cilësia e këtij prodhimi, aq më shumë duhet të përfitojë individi që prodhon.
- Vështirësia e vendosjes së matësve objektivë për vlerën e produkteve të prodhuara prej individit, sidomos në fusha të tilla si shkenca, arti, edukimi, teknologjia, mjekësia, etj.
- disa autorë supozojnë që vlera e produktit të prodhuar nga një individ duhet të përcaktohet nga faktorët e tregut - nga oferta dhe kërkesa.
- Por kjo metodë matjeje injoron nevojat e njerëzve. Për më tepër, për shumë njerëz, cmimet e tregut janë metoda matjeje të padrejta, pasi vetë tregu injoron vlerën e brendëshme të sendeve.

3. Drejtësia

- *Drejtësia e bazuar në nevojat dhe aftësitë :socializmi.*
- Parimi socialist për drejtësinë, pretendon se
- **puna duhet të shpërndahet në përputhje me aftësitë e njerëzve,** ndërsa
- **të ardhurat të shpërndahen në bazë të nevojave.**
- Sipas kësaj pikëpamje shoqëritë duhet të konsiderohen si komunitete, në të cilat **përfitimet dhe detyrimet shpërndahen duke përdorur modelin e një familjeje.**

3. Drejtësia

- kritikët theksojnë se sipas parimit socialist, nuk ka lidhje midis përpjekjeve që një individ bën në punë dhe sasisë së shpërblimit që ai merr
- Kritikët mendojnë, gjithashtu, se nuk mundet që e gjithë shoqëria të modelohet sipas marrëdhënieve familjare.
- në qoftë se parimi socialist do të imponohet me forcë, ai do të zhdukte lirinë e individit

3. Drejtësia

- *2- Drejtësia ndëshkuese..*
- Kjo lloj drejtësie ka të bëjë me drejtësinë e fajësimit apo të ndëshkimit të individëve, të cilët kryejnë gabime në mënyrë të vullnetëshme.
- Shpesh, njerëzit i kryejnë gabimet të ndodhur në kushtet e injorancës apo të paaftësisë.
- Kusht tjetër i drejtësisë së ndëshkimit është siguria apo bindja se individi që gjykohet është pikërisht ai që ka kryer gabimin.
- Së fundi, një ndëshkim i drejtë duhet të jetë në proporcion dhe në përputhje me gabimin e kryer.

3. Drejtësia

- **3-Drejtësia kompensuese.**
- Kjo lloj drejtësie ka të bëjë me kompensimin e një individi që ka pësuar një humbje si pasojë e veprimeve të gabuara të dikujt tjetër.
- Drejtësia kërkon që fajtori, sa më shpejt që të jetë e mundur, t'i kthejë viktimës një sasi kompensuese shlyese, gati të barabartë me masën e dëmit apo të humbjes që i ka shkaktuar atij.
- një individ ka obligim moral të kompensojë të dëmtuarin vetëm në se ekzistojnë tre kushtet e mëposhtme :
- **(a) Veprimi që shkakton dëmin është vërtet i gabuar apo rrjedh nga neglizhenca.**
- **(b) Veprimi i fajtorit është shkaku i vërtetë i dëmit**
- **(c) Fajtori e shkakton dëmin me ndërgjegje dhe në mënyrë të qëllimshme.**

Dobishmëria, të drejtat, dhe drejtësia

- qëndrojnë në themel të shumicës së gjykimeve tona morale.
- Standartet e dobishmërisë duhet të përdoren kur nuk kemi mundësi të kënaqim objektivat e të gjithëve.
- Pjesërisht, gjykimet tona morale bazohen në standarte që përcaktojnë se si duhet të trajtohen e respektohen individët.
- Gjykimet morale bazohen, gjithashtu, në standartet e drejtësisë të cilat tregojnë se si përfitimet dhe detyrimet e shoqërisë do të shpërndahen midis anëtarëve të një grupi.

Dobishmëria, të drejtat, dhe drejtësia

- Standartet e dobishmërisë shqyrtojnë vetëm mirëqënien sociale agregate, por injorojnë individin dhe mënyrën e shpërndarjes së mirëqënies.
- E drejta morale shqyrton vetëm individin, por ka rezerva ndaj mirëqënies agregate dhe mënyrave shpërndarëse.
- Standartet e drejtësisë shqyrtojnë problemet shpërndarëse, por injorojnë mirëqënien sociale dhe individin si të tillë.

Dobishmëria, të drejtat, dhe drejtësia

- Këto tre lloje konsideratash morale duket se nuk e mënjanojnë njeri -tjetrin;
- që të tre janë pjesë e nevojshme e moralitetit tonë, që do të thotë se ka probleme morale për të cilat standartet utilitariane janë decizive, ndërsa për probleme të tjera, decizive janë qoftë të drejtat e individit ashtu edhe drejtësia e shpërndarjes.
- Ky fakt sugjeron që aresyetimi moral duhet të përfshijë të tre llojet e mësipërme edhe pse në situata të caktuara duhet dhe mundet të përdoret vetëm njeri apo tjetri.

Dobishmëria, të drejtat, dhe drejtësia

- E drejta morale identifikon fushat në të cilat njerëzit nuk duhet të interferojnë, edhe pse mund të provojnë që prej këtyre interferencave do të arrijnë të gjenerojnë përfitime shumë të mëdha.
- Në përgjithësi, standartet e të drejtave morale kanë peshë e rëndësi më të madhe se sa standartet e dobishmerisë, apo të drejtësisë.
- Standarteve të drejtësisë u jepet më shumë rëndësi sesa atyre të dobishmërisë, por këto marrëdhënie janë të përgjithëshme.
- Në qoftë se një veprim i caktuar pretendon të gjenerojë përfitime sociale tepër të mëdha, madhësia e këtyre pasojave të dobishmërisë mund të justifikojë shkelje të kufizuara të të drejtave të disa individëve.
- Për më tepër, kosto dhe përfitime sociale shumë të mëdha, mund të jenë mjaft të rëndësishme për të justifikuar disa largime apo shmangie nga standartet e drejtësisë; dhe se korrigjimi i padrejtësive mund të jetë mjaft i rëndësishëm për të justifikuar shkeljen e disa të drejtave të individit.

- JU Faleminderit per vemendjen!